



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1016/5 prot

Datë 09.06.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 552/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.06.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, Nr. REF-27566-05-05-2022 me objekt “**Loti III. “Blerje letër”**” me fond limit 5,484,259.00 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara  
*Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.*
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK  
*Autostrada Tr - Dr, km 10, Kashar, Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi parashtimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06-05-2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, Nr. REF-27566-05-05-2022 me objekt “**Loti III**. “Blerje letër” me fond limit 5,484,259.00 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 12.05.2022 operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK ka paraqitur ankesë në mënyrë elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, me anë të Sistemit të Ankesave Elektronike, me numër ankimi elektronik A A/2022/2190, protokolluar me nr. 1016/2022 prot., datë 12.05.2022, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 786 prot., datë 17.05.2022 protokolluar me tonën me nr. 1017/2 prot., datë 18.05.2022 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit

kontraktor nr. 766/2 prot., datë 16.05.2022 lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit nuk ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK objekt-prokurimi, por ka kthyer një përgjigje për pretendimet e lotit II.

II.7. Komisioni i Prokurimit Publik me anë të shkresës nr. 1016/3 prot., datë 24.05.2022, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik trajtimin mbi ankesën e operatorit ekonomik ankimues, pasi nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur rezulton, se vendimi i dërguar nuk përmban përgjigjen në lidhje me trajtimin e ankesës së “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën objekt-ankimi, për sa i takon pretendimeve të ngritura në ankesë.

II.8. Referuar shkresës së sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka depozituar pranë komisionit të prokurimit shkresën me lënde “Kthim-Përgjigje” nr. prot 862/1 datë 27.05.2022 protokolluar me tonën nr. 1016/4 datë 31.05.2022 në lidhje mbi ankesat e paraqitura nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, mbi kriterin me pretendimin se:[...] *Kërkesa për kryerjen e testimi është një kërkesë praktikisht dhe teknikisht e pamundur për t’u realizuar nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës. Theksojmë këtu faktin se AK ka shkuar edhe me tej në kërkesat e saj duke pretenduar që "Raporti i testeve përkatëse duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara, jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK". Kjo kërkesë është jo ligjore dhe mbi të gjitha jashtë natyrës së mallrave objekt prokurimi. Testimi pas datës së nënshkrimit të Kontratës do të mund të aplikohet për mallra të cilat ndryshojnë karakteristikat e tyre të përbërjes në kohë, karakteristikë kjo që nuk lidhet aspak me mallrat objekt ikësaj procedure të cilat për shkak të natyrës së tyre janë rezistent dhe nuk ndryshojnë karakteristikat me kalimin e kohës.*2. *AK specifikon se analiza duhet të kryhet në një laborator të akredituar ndërkohë që referuar në interesimin tonë pranë DPA, aktualisht nuk ekziston asnjë laborator i akredituar i cili mund të kryej testimet në lidhje me përmbushjen e kriteve të CE3.Raportet testimet behën vetëm për produktet që duhet t'i rezistojnë një mekanizmi të caktuar prodhimi dhe duhet bërë testimi vetëm në kuader të standardit të prodhimit.*4. *Produktit Leter ka skedë teknike dhe kjo vlen vetëm për letren A4 apo A3. Letrat e kategorive të tjera janë produkte baze që nuk i takojnë standardizimit të cilesive me skedë teknike por vetëm me deklarata nga distributorët që merren me importimin e letres.*5. *Raport testimet nuk ka arsye pse të kryhen pas lidhjes së Kontrates, DST saktëson "jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontrates". Sikurse përmendëm raport-testimet nuk realizohen dot në*

*Shqipëri nga asnje institucion i akredituar ku mund të shkojme të testojmë produktet. Raport-testimet realizohen nga prodhuesit në momentin që standardizon PRODHUESI PRODUKTIN apo procesin dhe jo kur na nevojitet në të aplikojmë në tender. [...]Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën nr.7, Loti III “Blerje letër” në pikën 6 në seksionin kapaciteti teknik 2.3 , të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

**6. Me nënshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi të paraqes pranë AK raport testimet perkatëse për çdo produkt si dhe certifikatat e konformitetit ose të cilësisë CE/ ekuivalent si dhe certifikatën e origjinës. Për këto të paraqes detyruesisht një deklaratë se çdo produkt do të shoqerohet me raportin perkatës si dhe me certifikimet perkatëse të cilat duhet të jenë sipas kërkesave/ specifikimeve të AK-së. Raport i testeve perkatëse duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara, jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK.**

III.1.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe pika 4 “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

[...]

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

III.1.5. Në nenin 40 pika 5 germa a) dhe pika 6 germa c) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

[...]

*6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike*

III.1.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, duke modifikuar kriterin në lidhje me kriterin “6. Me nënshkrimin e kontratës dhe dorëzimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi të paraqes pranë AK raport testimet përkatëse për çdo produkt si dhe certifikatat e konformitetit ose të cilësisë CE/ekuivalent si dhe certifikatën e origjinës. Për këto të paraqes detyrimisht një deklaratë se çdo produkt do të shoqërohet me raportin përkatës si dhe me certifikimet përkatëse të cilat duhet të jenë sipas kërkesave/ specifikimeve të AK-së. Raport i testeve përkatëse duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara, jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për

procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjisllacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi i termave të referencës/specifikimet teknike, Komisioni gjykon se bazuar në objektin e procedurës së prokurimit, rëndësisë, volumit dhe elementet konkrete të kontratës objekt-prokurimi, kërkesat e mësipërme për disponimin e certifikimeve të kërkuara nga ana e autoriteti kontraktor, KPP gjykon, se nuk është kërkesë e ekzagjeruar, pasi për autoritetin kontraktor, është e rëndësishme të sigurohet që operatorët ekonomikë ofertues të disponojnë produktin, por duke u siguruar për cilësinë e saj me anë të një kërkesë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se paraqitja e certifikatave të konformitetit/ raport testimave dhe cdo dokumentacioni që lidhet me cilësinë për produktet objekt-prokurimi “*Blerje Leter*”, është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, për shak të natyrës së produktit. Autoriteti kontraktor është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që prokurohen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin Raport-Testimet përkatëse, për çdo produkt, si dhe certifikatës së konformitetit të cilësisë CE/ekuivalent, si dhe certifikatën e origjinës. mbështetur në nenin 40 të VKM 285 dt 19.05.2021 pika 6 c) 6 *Autoriteti/enti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: /ose b) dëshmi për rezultatet e testimave zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

Autoriteti Kontraktor me anë të kësaj kërkesë nuk vendos kufizim, por jep mundësi dhe alternativa të ngjashme, që vërtetojnë sigurinë dhe cilësinë e mallit pa cenuar standardet, duke i lënë hapësirë operatorit ekonomik të paraqesë një dokument të barasvlershëm me certifikatën e konformitetit në lidhje me standardet e kërkuara.

Pretendimet e operatorit ekonomik nuk qëndrojnë .

III.1.4.1 Për sa i përket afatit në kriterin e mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik në lidhje me kriterin e vendosur nga ana e autoritetit kontraktor “*Me nenshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave objekt prokurimi te paraqes prane AK raport testimet perkatese per cdo produkt si dhe certifikatat e konformitetit ose të cilësisë CE/ekuivalent si dhe certifikatën e origjinës. Per kete te paraqese detyrimisht nje deklarate se cdo produkt do te shoqerohet me raportin perkates si dhe me certifikimet perkatëse të cilat duhet të jenë sipas kërkesave/ specifikimeve të AK-së. Raport i testimave përkatëse duhet të jetë lëshuar*

nga organet kompetente të akredituara, jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK” vëren, se vendosja e togfjalëshit në kriterin e mësipërm “Me nënshkrimin e kontrates dhe dorezimin e artikujve operatori ekonomik krahas mallrave dhe Raport i testimave përkatëse duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente të akredituara, jo më herët se ditën e nënshkrimit të kontratës pranë AK” Autoriteti Kontraktor kërkon përmbushjen e këtij kriteri pas fazes së vlersimit të ofertave dhe njoftimit të fituesit pra, ky kriter nënkupton përmbushjen nga operatori ekonomik fitues dhe jo pjesëmarrësit e saj pas njoftimit të fituesit, është një kriter kualifikimi në procedurë dhe jo kriter për përmbushje pas shpalljes së fituesit.

Ky kriter krijon konfuzion dhe është në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. përkatësisth nën 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” date 13.12.2020.

Gjithshtu në lidhje me Raportin e testimave afati i kërkuar nga autoriteti kontraktor është në kundërshtim me ligjin pasi kjo kërkesë është kufizuese dhe ulë konkurrencën pasi operatorët ekonomik pjesëmarrës mund të dorezojnë raport testimave dhe të një date të mëparshme.

Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin duke lejuar dhe afate të tjera ose periudha të caktuara për të cilat kjo raport testimave janë të vlefshme dhe të lëshuara nga një organ i akredituar. Autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Marketing & Distribution” SHPK, për modifikimin e kriterit me pretendimin se: [...] *Mostrat duhet të jenë pjesë e procesit kualifikimit dhe nuk mund të dorezohen pesë ditë nga shpallja e fituesit pasi kualifikimi duhet të bëhet duke krahasuar dhe mostrat e gjithë operatorëve konkurrent. Mostrat nuk janë subjekt krahasimi absolut por relative duke krahasuar një mostër me tjetrën, duke krahasuar operatorin A dhe B. Nga sa më sipër, kërkojmë modifikimin e kriterit nga dorezimi i mostrave pesë ditë nga shpallja e fituesit, në ditën e hapjes së ofertave.[...]*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.7, Loti III “Blerje Letër” në pikën 7 në seksionin kapaciteti teknik 2.3, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

I. *Operatori ekonomik në fitues përfundimtar, përpara nënshkrimit të marrëveshjes kuadër, duhet të depozitojë pranë Agjencisë së blerjeve të Përqendruara, mostrat e artikujve të si mëposhtë, të cilat duhet të jenë të shoqëruar me certifikatat e konformitetit ose të cilësisë CE/ekuivalente, dhe certifikatën e origjinës dhe të jenë në përputhje të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.*

<b>LOTI 3: “BLERJE LETËR”</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i produktit</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasia e kërkuar</b>
1	Letërfotokopje, 80gr/m2	risma 500 fletë	1
2	Letër fotokopje 80gr/m2 ngjyra të ndryshme	risma 500 fletë	1
3	Letër fotokopje A3	risma 500 fletë	1
4	Letër fotografike	pako	1
5	Letër adezive	fletë	1

6	Letër karboni	pako	1
7	Etiketa adezive të mëdha	kuti	1

III2.2 Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III 2.3 . Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 38 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;”

III2.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin e kritereve specifike, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, përcaktojnë kriteret e kualifikimit duhet të jenë: (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe (ii) jodiskriminuese, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Në interpretimin teleologjik (qëllimit) të dispozitës së sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se qëllimi i vendosur nga ligjvënësi, është dhënia e mundësisë së autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike (referuar nenit 21 pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin



*Publik*” të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) nga autoriteti kontraktor, të mostrave të dorëzuara, në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Ligjvënësi ka kufizuar të drejtën e autoritetit kontraktor mbi vendosjen e kriterit të mësipërm të kualifikimit në respekt të parimit të proporcionalitetit, si një parim gjithëpërfshirës në ligjin e prokurimit publik, duke e lidhur vendosjen e kriterit me rëndësinë që ka për vlerësimin e ofertës teknike. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin, nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 të LPP-së. Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e synimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, si edhe kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për disa nga artikujt objekt-prokurimi. Referuar nenit 40, pika 6 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kërkesa për paraqitjen e mostrave, parashikohet si një ndër kërkesat e cila duhet përmbushur për kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Pra, ligjvënësi ka parashikuar këtë kërkesë, si një kriter i cili duhet përmbushur nga operatori ekonomik, i cili synon të fitojë kontratën, si dhe ti shërbejë autoritetit kontraktor me qëllim verifikimin nëse produktet e paraqitura plotësojnë kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pra në fazën e vlerësimin të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurë. Sa më sipër, kërkesa mbi momentin e dorëzimit të mostrave “*jo më vonë se pesë ditë nga shpallja e njoftimit përfundimtar të fituesit*”, është një kërkesë e cila nuk i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor, pasi sipas nenit 40 të VKM, kërkesa për dorëzimin e mostrave është një kriter kualifikimi në procedurë dhe jo kriter për përmbushje pas shpalljes fitues.

Sa më sipër autoritetit kontraktor, të modifikojë kërkesën e mësipërme në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Kërkesa e operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK, për pasaktësinë në përputhje me tabelat e artikujve:

*Ka pasaktësi dhe mospërputhje në tabelat e artikujve. Në tabelën e përgjithshme të hedhur në DST, lista ka 7 (shtatë) artikuj të renditur. Ndërkohë, në tabelën e specifikimeve teknike gjenden të listuara 8 (tetë) produkte. Specifikisht, produkti që mungon tek lista është "Letër në vazhdim për printer". AK duhet të beje saktësimet e nevojshme pasi cdo pasaktësi mund të perbeje shkak për konfondimin e OE pjesëmarrës dhe më pas për skualifikimin e tyre.*

III.3.1 Në shtojcën nr.6 Loti III “Blerje Letër”, të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon;

#### **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

## FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

### Loti III. "Blerje letër"

Sasia e mallit që kërkohet:

<b>TABELA E PËRGJITHSHME</b>			
<b>LOTI 3: "BLERJE LETËR"</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Emertimi i produktit</b>	<b>Njësia matëse</b>	<b>Sasite e pritshme</b>
1	Letër fotokopje, 80gr/m2	risma 500 fletë	<b>10800</b>
2	Letër fotokopje 80gr/m2 ngjyra të ndryshme	risma 500 fletë	<b>120</b>
3	Letër fotokopje A3	risma 500 fletë	<b>220</b>
4	Letër fotografike	pako	<b>100</b>
5	Letër adezive	fletë	<b>122</b>
6	Letër karboni	pako	<b>2</b>
7	Etiketa adezive të mëdha	kuti	<b>14</b>

III.3.2. Në Dokumentet e tenderit "*Specifikime teknike finale blerje materiale kancelarie*" Loti III "Blerje Letër", të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon;

#### 1.1. LOTI III: "Blerje letër"

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Specifikime teknike</b>
1	Letër fotokopje, 80gr/m2	risma fletë      500	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Përmasa 29.7x210, A4.</li> <li>-Lëmueshmëria: 80-130 ml/min.</li> <li>-Amballazhimi: Mbështjellje kundër lagështirës dhe kuti me kapacitet 5 risma.</li> <li>-Përdorimi për fotokopje dhe printim.</li> <li>-Lagështia: 3.5-4.5%.</li> <li>-Trashësia: 103-115 µm.</li> <li>-Dukshmëria:&gt;94%.</li> <li>-Shkëlqimi: 101-115%.</li> <li>-CIE bardhësia: 148-170.</li> <li>-Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin.</li> <li>-Të qëndrojnë e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit.</li> <li>-Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit.</li> <li>-Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët.</li> <li>-Të plotësojë standardet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë sipas ISO-s 9706 ,80 gr/m<sup>2</sup></li> <li>-Të mos jetë e ricikluar.</li> <li>-Me risma 500 flete secila.</li> </ul>
2	Letër fotokopje 80gr/m2 ngjyra të ndryshme	risma fletë      500	Letër fotokopje A4, 80gr/m <sup>2</sup> .

3	Letër fotokopje A3	risma fletë 500	Letër fotokopje A3, 80gr/m <sup>2</sup> ngjyra e bardhë.
4	Letër fotografike	pako	Letër për fotografi A4 50 fletë.
5	Letër adezive	fletë	Letër adezive e bardhe, 70x100cm.
6	Letër në vazhdim për printer	kuti	Letër e bardhe për printer matricor permasa 24cm x 11" kuti me 2000 fletë.
7	Letër karboni	pako	Leter karboni A4, për kopje dokumentash deri 2 flete, të mos krijoje zhytje/vjellje në leter, të jete reziztuese ndaj lagështirës dhe gjate punës. Pako me 50 fletë.
8	Etiketa adezive të mëdha	kuti	Etiketa adezivite të medha, në kuti, kutia me 100 fletë A4.

III.3.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në ankesë, mbi mospërputhjen e numrit të artikujve në sasinë e mallit që kërkohet në formularin e sasisë dhe grafikut të lëvrimit Loti III. **“Blerje letër” dhe me numrin** e artikujve në specifikimet teknike, Komisioni konstaton se ka mospërputhje të numrit të artikujve në specifikimet teknike dhe në sasinë e mallit që do të lëvrohet në shtojcën 6, duke shkaktuar paqartësi te operatorët ekonomikë të interesuar, për hartimin e ofertave. Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor ka lënë vend për konfuzion, pasi ka mospërputhje në lidhje me numrin e artikujve, për të cilat operatori ekonomik do të ofertoje, mospërmbushja e të cilave mund të përbëjë shkak për skualifikim. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të unifikojë numrin e artikujve për të cilat operatori ekonomik do të ofertojë, në mënyrë që të krijohet panoramë e qartë mbi produktet që do të ofrohen, si dhe të mos krijohet konfuzion tek operatorët ekonomikë të interesuar për të hartuar ofertat e tyre teknike dhe ekonomike. Vlen të theksohet, se dokumentet e tenderit, nga autoriteti kontraktor, duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK për procedurën e prokurimit ‘E hapur, mbi kufirin e lartë monetar’, Nr. REF-27566-05-05-2022 me objekt “**Loti III. “Blerje letër”**”, me fond limit 5,484,259.00 leke pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Marketing & Distribution” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

